

Më
Data

01-10-2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM,
DIVIZIONI PENAL, me gjyqtaren individuale Hakile Ilazi dhe me zyrtaren ligjore
Ganimete Avdiu, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR], për shkak të veprës
penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 nen par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së
Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.II. nr.566-1/15 e datës 17.05.2017, në prezencën e
Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu, të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe mbrojtësit tij me
autorizim Av. [REDAKTUAR], pas mbajtjes së seancës dëgjimore për shqyrtimin e
marrëveshjes për pranimin e fajësisë, me datë 16.08.2018, mori dhe publikisht komunikoi,
këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari: [REDAKTUAR], nga Drenasi rr. [REDAKTUAR], i lindur me [REDAKTUAR] ne te
njëjtin vend, nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], shqiptar, shtetas i Republikës
së Kosovës, me profesion tregtar i automjeteve, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 09.12.2014 rreth orës 15.55 ne rrugën “Adem Jashari” përball firmës
tregtare “Migros” në Shtime, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e
që vetit të i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me forcë ka hapur automjetin e të
dëmtuarit [REDAKTUAR] agjent tregtar i firmës [REDAKTUAR], ka marrë cigare të llojeve
Winston dhe Ronson e ku vlera e tyre sipas të dëmtuarit sillet rreth 2,486.60€.

me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 nen par.1 të
KPRK-së,

Andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 399 par. 1 pika 1,1 të KPRK-së, si
dhe neneve 7,17,41,42,43,46,69,73, të KPRK-ës nenit 233 dhe nenit 365 të KPPK-ës, të
akuzuarin e,

GJYKON
DENIM ME KUSHT

Të akuzuarin [REDAKTUAR] gjykon me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1/një/ viti i cili dënim nuk do te ekzekutohet në rast se i akuzuari brenda 2 /dy/ viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale (koha e verifikimit) dhe

DENIM ME GJOBE ne shumë prej 700(shtatëqind) euro te cilën gjobe do ta paguaj ne afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna Shtime, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 25 /njëzet e pesë/ Euro, si dhe për fondin e viktimave te krimit shumen prej 30/tridhjetë/ € në afat prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka paraqitur aktakuzën PP.II. nr.566-1/15 e datës 17.05.2017, ndaj të akuzuarit [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 nen par.1 të KPRK-së.

Prokuroria e shtetit aktakuzës i ka bashkangjitur Marrëveshjen për pranimin e fajësisë pas mbajtjes së seancës gjyqësore me dt.11.12.2017, te datës 12.06.2018, deklaratën e të pandehurit [REDAKTUAR] të datës 12.06.2018 te nënshkruar nga ana e të pandehurit, mbrojtësit të tij Av. [REDAKTUAR], prokurores së shtetit Sebahate Sinani dhe kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj Shukri Jashari.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze me datën 16.08.2017 ka mbajtur seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë së datës 12.06.2018, në të cilën i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit u deklaruan përkitazi me marrëveshjen

e pranimit të fajësisë duke i propozuar gjykatës pranimin e kësaj marrëveshje sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara sipas dispozitës së nenit 233 par. 18 të KPPK-së, se:

- I akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë,
- Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe se i akuzuari nuk kanë qenë i detyruar e as i shtrënguar në asnjë mënyrë që ta pranojë fajësinë,
- Pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe materialet e prezantuara nga prokurori dhe atë: deklarata e të pandehurit e datës 23.12.2014 dhe 12.06.2018, si dhe deklarata e të dëmtuarit e dt.24.12.2014 dhe 22.02.2018.
- Si dhe nuk ekzistoni asnjë rrethanë e parapare nga neni 253 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Andaj gjykata i pranoi marrëveshjet për pranimin e fajësisë dhe bazuar në këtë marrëveshje vazhdoi me shqiptimin e dënimit për të akuzuarin.

Gjykata duke vlerësuar aspektin juridik gjeti se në veprimet e të akuzuarit [REDAKTUAR] ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 nen par.1 të KPRK-së, meqë me date, kohë dhe vend si është përcaktuar në diapozitiv të këtij aktgjykimi, e ka kryer këtë vepër penale. Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori se kanë arritur marrëveshje për pranim fajësisë, baba i nje fëmije, përkatësisht mbajtës i familjes, nuk është i njohur me pare se është kryerës i veprave te tilla apo te ngjashme penale, në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale dhe bazuar në faktin se i pandehuri ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë, me dënimet e shqiptuara do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i përcaktuar me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjeneralë, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Konform nenit 458,459,dhe 460, i dëmtuari [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.


Konform neneve 450 të KPPK-së, obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 25 /njëzet e pesë/ €uro, si dhe shumën prej 30/tridhjetë/ € në afat prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit. Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 pika 3.1 Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin të viktimave të krimit.

Nga arsyet e lartë cekura është vendosur si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal
P.nr.1214/17 të dt. 16.08.2018**

Zyrtarja Ligjore,
Ganimete Avdiu

Gjyqtari
Hakile Ilazi



KËSHILLA JURIDIKE – kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit Kosovë, në afat prej 15/pesëmbëdhjetë/ditësh. Kurse i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.